



**Për: Mediat e shkruara dhe elektronike në Kosovë**

**Nga: Departamenti për Marrëdhënie me Publik dhe Informim**

**Subjekti: Telegram ngushëllimi me rastin e dy vjetorit të vdekjes së Presidentit të Kosovës, dr. Ibrahim Rugova**

---

*Prishtinë, 22 janar 2008*

## **NJOFTIM PËR MEDIA**

Kryetari i Aleances Kosova e Re, z. Behgjet Pacolli i shpreh ngushëllimet më të sinqerta familjes Rugova, me rastin e dy vjetorit të vdekjes së familjarit të tyre të dashur, Presidentit të Kosovës, dr. Ibrahim Rugova.

Sot është një ditë e përkujtimit, e dhimbjes për humbjen e Presidentit të parë të Kosovës, njeriut të shkencës, humanizmit dhe vizionarit dr. Ibrahim Rugova. Me nderim dhe respekt, familjes Rugova, i shprehim konsideratën më të thellë dhe i sigurojmë se jemi të gjithë në rrugë të përbashkët, në përmbushjen e idealeve për bërjen e Kosovës shtet të pavarur dhe sovran për çka presidenti Rugova u përkushtua aq shumë.

**Me respekt,  
Behgjet Pacolli**